



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:243972

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06574104

PKR.nr.482/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionist Gëzim Ademi dhe Fatime Dermaku, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arxhenita Vokshi, në çështjen penale ndaj të pandehurve, Flamur Kuçi dhe Blerina Sallaj për shkak të veprës penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.771/2021 të dt.13.09.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, me dt.08.11.2024 në të cilin ishin prezent Prokurorja e shtetit Fitore Sadikaj, të akuzuari Flamur Kuçi, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av. F.M, e akuzuara Blerina Sallaj me mbrojtësin e saj sipas autorizimit Av.G.H, me datë 12.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.12.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. FLAMUR KUÇI nga i ati ... dhe nëna ... e gjinisë ... i lindur me dt.... i lindur në ... me vendbanim në rr.” ...” në ..., objekti ... me numër personal ... i pa martuar, student, punon në “...”, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data 30.10.2021 deri me 26.11.2021.

II. BLERINA SALLAJ nga i ati ...dhe ëma ..., e gjinisë ... e lindur me dt.... në ..., ku edhe jeton në lagjen ... p.n me numër personal ..., e pa martuar, ka të kryer Fakultetin e Gjermanishtes, punon si Trajnere në një OJQ në ... e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP të Republikës së Kosovës,

Të akuzuarit: Flamur Kuçi dhe Blerina Sallaj,

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse:

Të akuzuarit, në bazë të marrëveshjes paraprake e me qëllim të ndryshimit të rezultateve të votimit në zgjedhjet për Kryetar të komunës, kanë tentuar që të votojnë në emër të personave të tjerë në atë mënyrë që me datën 29.10.2021, rreth orës 16:30 minuta, në Aeroportin Ndërkombëtar në Prishtinë “Adem Jashari”, gjatë kontrollimit të të pandehurës Blerina Sallaj, nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës i janë gjetur shtatë kopje të letërnjoftimeve të personave: Kimete Miroci, Sadik Miroci, Shaqë Miroci, Smajl Miroci, Jeton Miroci, Atifete Miroci dhe Shkurte Miroci si dhe dy kopje të pasaportave në emër të Armire Miroci dhe Alban Miroci si dhe një listë me emrin, Diaspora voton përmes postës 2021, ku në atë listë janë të shënuara 125 emra e mbiemra, adresa si dhe shtetet ku jetojnë e të cilat të pandehurës ia kishte dhënë i akuzuari Flamur Kuçi, që t’i dërgojë në Minhen të Gjermanisë, me qëllim që të votohet në emrat e atyre personave, pasi që babai i tij ... ishte në garë për ballotazh për Kryetar të komunës së Junikut, ndërsa pas ekzaminimit të laptopit të të pandehurës janë gjetur edhe foto të pasaportave të personave: Ibrahim Himaj, Florentina Himaj, Afërdita Himaj Miroci, Sami Gaxherri, Lumnije Gaxherri, Lume Gjota si dhe foto të letërnjoftimeve të personave: Malë Gjota, Ramiz Miroci si dhe formularët për aplikim për votim jashtë Kosovës, në emër të personave: Florentina Hebibi, Jeton Krasniqi, Latif Krasniqi, Rexhep Krasniqi, Sevdije Krasniqi, Shemsedin Hebibi, Tushe Krasniqi, Zamire Krasniqi, Ruke Hebibi, Adonis Qollaku, Agonis Qollaku etj.,-

-sepse nuk është provuar se të akuzuarit se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, kanë kryer veprën penale, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Të pandehurës Blerina Sallaj i kthehet Laptopi “ACER”, ngjyrë e zezë dhe me mbushës me nr.SNID 9340037157 dhe një telefon i tipit “Samsung A50”, ngjyrë e zezë, me IMEI 1:358583102073155/01 dhe IMEI 2:358584102073153/01.

Nuk ka pasur të propozuar palë të dëmtuar.

A r s y e t i m

Rrjedhja e procedures:

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzën me numër PP.I.nr.771/2021 të dt.13.09.2022, ndaj të akuzuarve Flamur Kuçi dhe Blerina Sallaj për shkak të veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 31.10.2024 dhe datë 08.11.2024 në këtë çështje penale, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurorja e shtetit, të akuzuari Flamur Kuçi me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.F.M, e akuzuara B.S me mbrojtësin e saj sipas autorizimit Av.G.H.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit të akuzuarve iu dha mundësia e deklaramit të tyre lidhur me aktakuzën, të njëjtit secili veç e veç u deklaruan të pafajshëm për veprën penale e cila iu vihej në barrë sipas aktakuzës.

Pasi që të akuzuarit secili veç e veç u deklaruan të pafajshëm për veprën penale e cila iu vihej në barrë sipas aktakuzës, gjykata vazhdoi me paraqitjen e radhës së provave në shqyrtimin gjyqësor, me fjalën hyrëse të palëve, me administrimin e provave materiale, me mbrojtjen e të akuzuarve si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e Shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se lënda e këtij shqyrtimi është lënda me numër PP.I.771/2021, kundër Flamur Kuçi dhe Blerina Sallaj në drejtim të veprës penale në bashkëkryerjeje e në vazhdimësi, Keqpërdormi i drejtës së votimit nga neni 213 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së. Gjatë këtij shqyrtimi pas administrimit të provave u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit e kanë kryer këtë vepër penale, përtej dyshimit të bazuar mirë u vërtetua nga provat të cilat u administruan në këtë shqyrtim si: Lista e votuesve e emëruar si Diaspora voton përmes postës 2021, nga e cila u vërtetua se të akuzuarit fillimisht kanë siguruar listën e votuesve dhe më pastaj atyre personave ua kanë marr kopjet e dokumenteve të identifikimit të pasaportës dhe letërnjoftimit me qëllim që t'i përdorin me rastin e votimit nga diaspora, kjo gjendje faktike u vërtetua edhe nga analizimi i dëshmimeve të nxjerra nga Laptopi i të akuzuarës Blerina Sallaj ku pas ekzaminimit ka rezultuar se në laptopin e saj

janë gjetur fotot e pasaportave, letërnjoftimeve si dhe formularëve për aplikim dhe votim, me postë jashtë Kosovës në emër të personave të cilët kanë qenë në listën e votuesve të cilën e kanë siguruar më parë, gjendja e njëjtë vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës. Në fund ka kërkuar nga trupi gjykues që mos t'ia fal besimin mbrojtjes së të akuzuarve, pasi që me provat e tjera u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe propozoj që të njëjti të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Flamur Kuçi av. F.M fjalën e tij përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe të njëjtën e elaboroi në pika të shkurtra në të cilën ka deklaruar se mbetet pranë pretendimeve se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një veprë bazë, pasi që asnjë veprim i të mbrojturit të tij nuk i përmbush asnjë prej elementeve të veprës penale konkrete me të cilën akuzohet i njëjti e gjithashtu nuk përmbushen asnjë prej elementeve të ndonjë veprë tjetër penale, duke e kundërshtuar në tërësi aktakuzën si në fjalën hyrëse, pasi që nuk ka prova të mjaftueshëm për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet e që sipas kësaj aktakuze nuk përcaktohet qartë se cilat veprime konkrete i ka bërë i mbrojturi i tij, nuk dihet shkaku, nuk është përcaktuar as pasoja, kush ka qenë palë e dëmtuar, e gjithashtu nuk vërtetohet dashja që i mbrojturi i tij të ketë pasur dashje për kryerjen e veprës penale. Ka shtuar se sa i përket ushtrimit të ndikimit në të drejtën e votimit nuk përmbushet asnjë prej elementeve të kësaj veprë penale pasi që i akuzuari nuk ka pasur pozitë apo mundësi që të ketë mundësinë për ushtrimin e ndikimit, duke shtuar se i njëjti nuk ka qenë në ndonjë pozitë si: në komisionin qendror zgjedhor, apo në ndonjë prej pozicioneve me anë të së cilit ka pasur mundësi të ndikojë në procesin zgjedhor. Ka deklaruar se në periudhën në të cilën akuzohet i mbrojturi i tij ka qenë tri javë para procesit të votimit apo para ditës së zgjedhjeve e si ka pasur mundësi që tre javë më parë të ketë pasur ndikim, duke shtuar se në asnjë moment nuk vërtetohet të ketë pasur blerje të votës, dhënie e favoreve apo presion për të votuar ndonjë kandidat të caktuar. Ka shtuar se dispozitivi i aktakuzës së paraqitur nuk përmban elementet e aktakuzës të përcaktuar në nenin 241 par.1.4 të KPPRK-së e që është përcaktuar se Aktakuza duhet të përmbajë “kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat e tjera të nevojshme për të caktuar me saktësi veprën penale”. Ka deklaruar se organi i akuzës në rastin konkret nuk ka argumentuar ekzistimin e veprës penale apo aktivitetit kriminal më rrethanat e rastit konkret, më saktësisht në aktakuzë nuk tregohet, përfshihet, dëshmohet ndonjë element konstituiv i veprës penale. Ka theksuar se në rastin konkret prokuroria nuk bën ndërlidhjen e veprimeve faktike me elemente të veprave penale që i

ngarkohet të akuzuarit Flamur Kuçi të përcaktuara me nenet 213 pika 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, e që organi i akuzës përshkruan apo pohon disa veprime të akuzuarit por pa ofruar prova dhe argumente të qëndrueshme se ato veprime korrespondojnë në çfarëdo mënyre me figurën e veprës penale. Ka shtuar se sa i përket standardit të dyshimit të bazuar, GJEDNJ-ja ka theksuar se kërkesa që dyshimi të jetë i mbështetur në baza të arsyeshme paraqet garancinë qenësor kundër fajësisë. Në fund gjykatës i ka propozuar që ndaj Flamur Kuçit gjykata të nxjerr Aktgjykim lirues sepse gjatë procedurës nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari Flamur Kuçi në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrah plotësisht fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarës Blerina Sallaj av.G.H fjalën e tij përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe të njëjtën e elaboroi në pika të shkurtra në të cilën ka deklaruar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një vepër penale bazë, pasi që asnjë veprim i të mbajturës së tij nuk i përmbush asnjë prej elementeve të veprës penale konkrete me të cilën akuzohet, e gjithashtu nuk përmbushen elementet të ndonjë vepre tjetër penale. Ka theksuar se mbesim pranë kundërshtimeve të aktakuzës pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet e që sipas kësaj aktakuzë nuk përcaktohet qartë se cilat veprime konkrete i ka bërë e mbrojtura e tij, nuk dihet shkaku, nuk është përcaktuar as pasoja, kush ka qenë palë e dëmtuar, e gjithashtu nuk vërtetohet dashja që e mbrojtura e tij të ketë pasur dashje për kryerjen e veprës penale, ka shtuar se sa i përket ushtrimit të ndikimit në të drejtën e votimit nuk përmbushet asnjë prej elementeve të kësaj vepre penale pasi që e mbrojtura e tij nuk ka pasur pozitë apo mundësi që të ketë mundësinë për ushtrimin e ndikimit, lidhur me periudhën në të cilën akuzohet e mbrojtura e tij ka qenë tri javë para procesit të votimit apo para ditës së zgjedhjeve andaj si ka pasur mundësi që tre javë më parë të ketë pasur ndikim, duke shtuar se në asnjë moment nuk vërtetohet të ketë pasur blerje të votës, dhënie e favoreve apo presion për të votuar ndonjë kandidat të caktuar. Ka shtuar se dispozitivi i aktakuzës së paraqitur nuk përmban elementet e aktakuzës të përcaktuar në nenin 241 par.1.4 të KPPRK-së, Prokuroria në rastin konkret nuk ka argumentuar ekzistimin e veprës penale apo aktivitetit kriminal më rrethanat e rastit konkret, më saktësisht në aktakuzë nuk tregohet, përfshihet, dëshmohet ndonjë element konstituiv i veprës penale. Ka shtuar se në rastin konkret prokuroria nuk bën ndërlidhjen e veprimeve faktike me element të veprave penale që i ngarkohet të pandehurës Blerina Sallaj të përcaktuara me nenet 213 pika 1 pika 1.1 lidhur me

nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, e që organi i akuzës përshkruan apo pohon disa veprime të pandehurës por pa ofruar prova dhe argumente të qëndrueshme se ato veprime korrespondojnë në çfarëdo mënyre me figurën e veprës penale. Ka theksuar se pretendimet krejtësisht hipotetik i prokurorit të shtetit nuk duhet të pranohet assesi nga gjykata sepse kjo përfundimisht përbënë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës me që nuk është argumentuar me asnjë provë dhe fakt, e gjithashtu GJEDNJ ka theksuar se kërkesa që dyshimi të jetë i mbështetur në baza të arsyeshme paraqet garancinë qenësor kundër fajësisë. Në fund gjykatës i ka propozuar që ndaj Blerina Sallaj gjykata të nxjerr Aktgjykim lirues sepse gjatë procedurës nuk është provuar se e njëjta ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

E akuzuara Blerina Sallaj në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

Provat e administruara:

Në shqyrtimin gjyqësor me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka shqyrtuar dhe administruar provat materiale, si në vijim:

- Lista e votuesve e emërtuar Diaspora Voton përmes postës 2021;
- Kopjet e letërnjoftimeve të personave Kimete Miroci, Sadik Miroci, Shaqë Miroc, Smajl Miroci, Shkurte Miroci, Jeton Miroci dhe Atifete Miroci, dy kopje të pasaportave në emër të Armire Miroci dhe Alban Miroci;
- Raporti informues për rastin 2021 YA 125 i dt. 18.07.2021
- Analizimi i dëshmimeve të nxjerra nga laptopi i të pandehurës Blerina Sallaj
- Foto dokumentacioni që gjenden në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin gjyqësor, pas administrimit të provave, i akuzuari Flamur Kuçi në mbrojtjen e tij të dhënë ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurori, nuk e ndien veten fajtor, ditën kritike i kujtohet veprimet të cilat i ka ndërmarr, është ftuar nga Policia për të dhënë dëshmi për Blerinën dhe kur ka shkuar aty nuk e din se pse dhe për çfarë arsye është ndaluar aty, pasi që atë ditë ka qenë ditë normale, e kanë thirr Blerina ose Artan Krasniqi dhe i kanë thënë se “jam ka shkoj unë apo shkon ti për me përcjell Blerinën në aeroport”, dhe i kishte kërkuar që ta dërgonte në aeroport dhe i akuzuari atë ditë vetëm e ka shoqëruar Avdyll Malokun, dhe e ka pa se gjoja që i akuzuari ja ka dhënë ato Blerinës por nuk është e vërtet se i akuzuari asgjë nuk i ka dhënë Blerinës. Qëllimi vetëm ka qenë me shoqëruar Avdylin dhe Blerinën për mos me lënë Avdylin vetëm, dhe s’ka pas diçka tjetër. Sa i përket pyetjes se ju në prokurori keni

deklaruar se keni qenë i angazhuar në pozitën për subjektin AAK a mund të na tregoni se çfarë pozite keni pas, i akuzuari është përgjigjur se “unë e kam pas babin dhe nuk kam pas ndonjë pozitë pra me detyrë por vetëm jam angazhuar me shokë të mi e kushërinjtë për babin tim”, dhe se sa i përket asaj që qëllimi ka qenë sensibilizimi i qytetarëve të Junikut që jetojnë jashtë Kosovës, i akuzuari është përgjigjur se “nuk e besoj që duhet me pas ndonjë detyrë të caktuar për sensibilizimin e qytetarëve nëse ti beson në një subjekt të caktuar politik”. E ka mohuar se ja ka dërguar apo dhënë Blerinës fotografit të dokumenteve të personave që janë banor të Junikut por që jetojnë në shtetet e Evropës dhe atë në Munih. Në fund ka deklaruar se nuk ka çfarë të shtoj, se nuk është fajtor, po ashtu është jurist dhe një person me sjellje të mira dhe nga ky proces i është dëmtuar edhe karriera e tij.

E akuzuara Blerina Sallaj në mbrojtjen e saj ka deklaruar se shfrytëzon të drejtën e saj ligjore që të mbrohet në heshtje dhe se qëndron pranë deklaratës së dhënë në procedurën paraprake në Polici se me datë 29.10.2021 nga aeroporti i Prishtinës kam pasur të shkon në Minhen të Gjermanisë të vëllai i saj ..., e që prej shtëpisë e deri në aeroport e ka dërguar vëllai i saj ..., kurse në aeroport ka qenë e vetme dhe po ashtu ka pasur të udhëton e vetme. Ka shtuar se policia në aeroport gjatë kontrollimit në bagazh ia kanë gjetur disa dokumente të ndryshme si: shtatë kopje të letërnjoftimeve, dy kopje të pasaportave dhe një listë me emra të personave të ndryshëm, për të cilat ka qenë e informuar vetëm në momentin kur policia ia ka treguar dhe se nuk e din kujt i përkasin ato dokumente. Ka shtuar se kopjet e letërnjoftimeve dhe pasaportave më datë 28.10.2021 tek shtëpia e saj ia ka dhënë kushëriri i saj i largët Flamur Kuçi dhe e ka porositur që t’ia dërgon personit Mërgim Kuçi i cili jeton në Gjermani dhe se arsyeja pse ia ka dhënë këto dokumente nuk e din e gjithashtu ato kanë qenë në një qese të tejdukshme por nuk i ka kushtuar vëmendje se çka ka pasur aty. Ka shtuar se listën me emra ia ka dhënë Flamur Kuçi dhe kjo listë ka qenë së bashku me dokumente të tjera dhe nuk e ka ditur se çka ishin ato dokumente por e ka kuptuar vetëm atëherë kur policia ia ka gjetur në bagazhin e saj në aeroport. Ka theksuar se qëllimi se pse ka shkuar në Gjermani ka qenë për vizitë familjare dy javore tek vëllai i saj Blerimi. Ka deklaruar se Flamur Kuçi nuk punon askund, është djali i kryetarit të Komunës së Junikut ... dhe se të njëjtin e ka kushëri të largët, ndërsa Leonard Llollumi, Shpejtim Kuçin, Fatmir Miroci dhe Avdyl Maloku i njeh pasi që të gjithë i ka bashkëvendës. Ka deklaruar se ka udhëtuar edhe herëve të tjera jashtë vendit për vizitë dhe hera e fundit që ka udhëtuar ka qenë para një muaji para ditës kritike dhe ka qenë në Zvicër, e që ka shkuara para zgjedhjeve dhe është kthyer para këtyre zgjedhjeve të fundit gjithashtu është hera e parë që dikush i ka dhënë diçka për të dërguar jashtë Kosovës. Ka deklaruar se nuk ka asnjë nga familjarët e ngushtë që ka ndonjë

pozitë në subjekte politike, nuk ka njohur saktësisht se si shkon votimi me postë nga diaspora, nuk ka njohuri se nëse dikush i ka mbushur një numër të zarfeve me fletëvotime dhe i ka dërguar për jashtë Kosovës, dhe nuk e dinë se ku i ka marr Flamur Kuçi kopjet e dokumenteve dhe listën me emra që ia ka dhënë të akuzuarës.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, në përputhje me nenin 360 të KPPRK-së, për veprën penale si në hyrje të këtij aktgjykimi ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha këto prova të administruara, për gjykatën nuk është kontestuese se ditën kritike, pra me datën 29.10.2021 e akuzuara Blerina Sallaj ishte duke udhëtuar nga Aeroporti Ndërkombëtar në Prishtinë “Adem Jashari” për në Minhen të Gjermanisë.

Po ashtu i kontestueshëm është fakti se ditën kritike rreth orës 16:30 minuta e akuzuara Blerina Sallaj në aeroport ishte kontrolluar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se pastaj edhe është ndaluar.

Nuk ishte kontestuese fakti se të akuzuarit Blerina Sallaj dhe Flamur Kuçi gjatë kësaj periudhe nuk ka ushtruar asnjë funksion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo ndonjë pozicion tjetër.

Faktet kontestuese:

Kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti se a e kanë kryer këtë veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, te akuzuarit?

Te akuzuarit, për këtë çështje penale nuk e ka pranuar fajësinë në asnjë fazë të procedurës dhe as në Gjykatë, te njëjtit e ka mohuar të kenë kryer këtë veprë penale.

Duke qenë se te akuzuarit e ka mohuar kryerjen e kësaj veprës penale sipas aktakuzës, gjykata, nga provat materiale nuk ka arritur të vërtetojë faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje penale, e që rrjedhimisht as fajësinë e të akuzuarve sa i përket kësaj veprë penale si në aktakuzë.

Nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në asnjë prej tyre nuk mund të konstatohet fajësia e të akuzuarve në raport me këtë vepër penale.

Nga Lista e votuesve e emëruar “Diaspora Voton përmes postës 2021”, evidentohen 125 emër dhe mbiemra të personave, amëza e tyre elektronike dhe shtetin ku jetojnë. Gjykata nuk mund t’ a vërtetoj faktin se te akuzuarit janë kryerës i kësaj vepre penale ngase në përshkrimin e kësaj liste askund nuk i ngarkon të akuzuarit si kryerës të kësaj vepre penale, pasi që kjo vepër penale kryhet në rastet kur ai/ajo e plotëson fletëvotimin e tjetrit pasi që personi tjetër e kalon *fletëregjistrimin*. Mirëpo në këtë rast kemi vetëm një listë me emrat e personave të ndryshëm “Diaspora voton përmes postës 2021”, dhe në fund të faqes së dytë janë emrat e dy personave Fitore B. Velijaj dhe Arian S. Xhuli si përpilues të kësaj liste mirëpo nuk ka ndonjë nënshkrim, kjo listë nuk ka logo të KQZ-së, nuk ka ndonjë fletëvotim të bashkangjitur e të nënshkruar dhe nuk përmban vulën.

Nga Raporti Informues për rastin 2021 YA 125 i datës 18.07.2021, rezulton se Sektori i Hetimeve të Krimeve të Rënda është bërë analizimi i dëshmimeve të nxjerra nga Laptopi i të pandehurës Blerina Sallaj, në të cilën janë gjetur foto të pasaportave, letërnjoftimeve si dhe formularët për aplikim për votim jashtë Kosovës në emër të personave të lartcekur, të cilat janë ekzaminuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, mirëpo posedimi i të njëjtave pa fletëvotim të plotësuar dhe të vulosur, nuk mund të vërtetojnë që të akuzuarit të kenë kryer veprën penale.

Nga Foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, rezultojnë kopje të dokumenteve të personave që janë gjetur të akuzuarës si dhe në laptopin e saj.

Pas analizimit të provave materiale shihet lista e votuesve e emëruar “Diaspora Voton përmes postës 2021”, kopjet e letërnjoftimeve dhe pasaportave të disa personave, mirëpo gjykata nuk mund të konsideroj si provë që vërteton se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të lartcekur ngase nuk kemi asnjë fakt apo provë që vërteton në radhë të parë marrëveshjen e të akuzuarve për të ndryshuar rezultatet e votimit për zgjedhjet për Kryetar të Komunës, se si e akuzuara Blerina Sallaj ka tentuar që të votojë në emër të personave të tjerë, pasi që nuk ka të plotësuar dhe të vulosur fletëvotim të tjetrit pasi që personi tjetër të ketë kaluar fletëregjistrimin, meqenëse nuk ka asgjë të përcaktuar si veprim të ndërmarr nga ana e tyre, nuk ka provë materiale që dëshmon saktësisht veprimin e secilit prej tyre, apo individualizmin e veprimeve të tyre lidhur me tentimin e tyre për të votuar me qëllim të ndryshimit të rezultateve të votimit, marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari Flamur Kuçi, në kohën për të cilën akuzohet nuk ka ushtruar ndonjë pozitë në komisionin qendror zgjedhor, në mënyrë që të ketë mundësinë për ushtrimin e ndikimit,

te i njëjti nuk është gjetur dëshmi/provë që ka të bëjë me këtë veprë penale, përveç deklarimit të bashkëpandehurës së tij se “Flamur Kuçi m’i ka dhënë këto dokumente për t’i dërguar në Munihi të Gjermanisë” e që një deklaratë e tillë gjykata nuk mund të akceptoj pasi që Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar se “Deklarata e të pandehurit të dhënë në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim nuk mund të shërbejë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar”, shtu faktin se periudha në të cilën akuzohen të akuzuarit ka qenë tri javë para procesit të votimit apo para ditës së zgjedhjeve, andaj nuk ka ekzistuar mundësia për blerje të votës, dhënie të favoreve apo presion për të votuar ndonjë kandidat të caktuar.

Pas analizimit dhe vlerësimit të këtyre provave gjykata gjeti se të akuzuarit nuk kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së.

Gjykata nuk mund të provoj se të njëjtit kanë kryer veprën penale, meqenëse nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk është arritur të dëshmohet se si kanë tentuar që të votojnë në emër të personave të tjerë, pasi që të njëjtit nuk kanë ushtruar ndonjë pozitë në komisionin qendror, apo të kenë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit të votimit, apo fletëvotimi i plotësuar për tjetrin të jetë i vulosur dhe se personi tjetri të këtë kaluar fletëregjistrimin, si proces i votimit.

Gjykata vërteton faktin se përveç, nga vetë deklarata e të akuzuarve të cilët e kanë mohuar kryerjen e veprës penale, edhe nga provat materiale në shkresa të lëndës si Lista e votuesve e emërtuar Diaspora Voton përmes postës 2021, kopjet e letërnjoftimeve dhe pasaportave të personave të lartcekur, Raporti informues për rastin, nuk është propozuar ndonjë provë tjetër konkrete gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe më pastaj, me krahasimin dhe analizimin e provave në fjalë në raport me mbrojtjen e të akuzuarve, ka konstatuar se të akuzuarit nuk kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, për të cilën janë akuzuar me aktakuzë dhe është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Një vlerësim të tillë gjykata e ka dhënë, pasi ka marr parasysh deklaratat e të akuzuarve të cilët edhe pse nuk janë deklaruar përkitazi me këtë, të njëjtit e kanë mohuar kryerjen e veprës penale. Po ashtu, gjykata ka marr parasysh edhe faktet dhe rrethanat se me asnjë provë në shkresa të lëndës nuk mund të vërtetohet se të akuzuarit kishin marrëveshje paraprake në mes tyre për kryerjen e veprës penale në fjalë, gjegjësisht për ndryshimin e qëllimshëm të rezultateve të votimit në zgjedhjet për Kryetar të komunës gjë që,

një gjë e tillë nuk rezulton as nga provat në shkresat e lëndës, e sidomos, nga lista diaspora voton 2021, listë kjo e përpiluar nga persona të tjerë dhe kopjet e letërnjoftimeve dhe pasaportave, në mungesë të fletëvotimit të plotësuar për tjetrin, të pavulosur dhe që personi tjetër i cili do të duhej të ketë kaluar fletëregjistrimin, nuk mund të vërtetohet se ndonjëri nga të akuzuarit kishin kryer çfarëdo veprimi për të ndryshuar rezultatet e votimit.

Prandaj, gjykata nuk mund ta vërtetoi dashjen e te pandehurve e as bashkëkryerjen për veprën penale si në aktakuzë. Gjykata, përveç të cekurave si më lartë, ka vërtetuar se sipas elementeve qenësore të veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, për të ekzistuar vepra penale në fjalë, do të duhet që tek të akuzuarit të vërtetohet ekzistimi i dashjes për të dëmtuar kandidatët, gjegjësisht, për favorizimin e ndonjërit nga ata, gjë që në rastin konkret nuk është vërtetuar se tek të akuzuarit ka ekzistuar dashja për votimin-tentimin për të votuar në emër të personave tjerë, për çka edhe janë liruar nga akuza, që do të thotë se në veprimet e të akuzuarve nuk përmbushen elementet e veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, sikur që pretendon prokuroria.

Sipas vlerësimit të gjykatës, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht, faktet jo kontestuese, përkitazi me mospërputhshmërinë e ndryshimit të rezultateve të votimit, me asnjë provë nuk vërtetohet se të akuzuarit me veprimet e tyre kanë bërë ndryshimin e rezultateve të votimit duke tentuar apo votuar në emër të personave të tjerë, dhe atë në bazë të ndonjë marrëveshje, sikur që pretendon prokuroria, ngase përveç pretendimit se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në fjalë, me asnjë provë apo shkresë tjetër në lëndë nuk vërtetohet një pretendim i tillë. Andaj, pretendimet e prokurorisë se të akuzuarit është dashur të shpallen fajtorë për këtë veprë penale, qartazi janë të pabazuara dhe pa mbështetje në prova apo në shkresa tjera të lëndës.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor vlerësoi pretendimet e Prokurorisë por e njëjta nuk arriti të argumentoj me fakte dhe prova para gjykatës elementet e veprës penale, në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilën veprë ngarkoheshin të akuzuarit, ngase nga provat e administruara nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, e që përbëjnë figurën e veprës penale të cekur më lartë për të akuzuarit, për të cilën akuzoheshin, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë gjykata pasi analizoi dhe vlerësoi provat e administruara dhe mbrojtjen e

të akuzuarve nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohet elementet e veprës penale të lartcekur dhe në mungesë të provave dhe mos ekzistimit të elementeve të veprës penale, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, të akuzuarit për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i liroi nga akuza.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të mbrojtësve dhe të akuzuarve, për çka gjeti se të njëjtat janë të bazuara në provat materiale dhe me mbrojtjen e të akuzuarve të dhëna gjatë këtij procesi gjyqësor, rezultojnë se me të drejtë nuk u provua se të akuzuarit të kenë kryer veprën penale, e cila është objekt i aktakuzës.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 48 të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka për obligim që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese, dhe të siguroj që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të akuzuarit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij kodi. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 242 të KPP-së, përcaktohet se në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës, bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore. Në rastin konkret prokuroria, nuk kishte siguruar prova të mjaftueshme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte do të mund të vërtetohej se i akuzuari, ka kryer veprën penale që akuzohet.

Andaj, nga të gjitha këto që u thanë më lartë, e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPP-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin “in dubio pro reo”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje me këtë, po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë, kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet. Për më tepër, është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë, lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pakontestueshme, në favor dhe disfavor të të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarve dhe të drejtave të tyre sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata, bazuar në arsyet dhe faktet e cekura si me lartë vendosi që të akuzuarit *në mungesë të provave, t'i lirojë nga akuza* e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.I nr.771/2021 te datës 13.09.2022, për veprën penale ne bashkëkryerje e vazhdimësi, Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së.

Trupi gjykues duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar me ndërgjegje një nga një dhe në lidhshmëri të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se te akuzuarit nuk e kanë kryer veprën penale ne bashkëkryerje dhe vazhdimësi Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 213 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KRPRK-së.

Shpenzimet e procedurës:

Kjo Gjykatë në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPPRK-së, ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bie në barrën e buxhetit të gjykatës, ngase kjo dispozitë përcakton në mënyrë shprehimore se kur i akuzuari lirohet nga akuza shpenzimet e procedurës penale nga neni 449 duhet të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, gjë që në rastin konkret sikurse është vendosur në dispozitiv të akuzuarit janë liruar nga akuza.

Vendimi mbi kthimin e sendeve

Vendimi mbi kthimin e sendeve është marrë konfom nenit 113 të KPPRK-së, për faktin se e akuzuara Blerina Sallaj është liruar nga aktakuza si dhe faktin tjetër se organi i akuzës, në këtë çështje penale, nuk ka siguruar asnjë provë të vetme, se sendet e sekuestruara nga e akuzuara janë përdorur për kryerjen e veprës penale, për çka edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.482/2022, me datë 10.12.2024

Zyrtare ligjore
Arxhenita Vokshi

Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja
Sulltane Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejte ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykatë, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.